



**VENDIM**

**Nr. 37 Datë 15.04.2011**

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“DN & NAT ENERGJI” SH.P.K NË AKTIVTETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.04.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b, c dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Subjekti DN & NAT ENERGJI ka informuar se është në proces të marrjes së lejes mjedisore dhe të miratimit të pikës së lidhjes të kërkuar nga neni 9 pika 4.1.5 i Rregullores

për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave duke plotësuar kërkesën e nenit 8 pika 4 te kesaj rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KUMBULL MERKURTH”.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**

*Nr. 37 Datë 15.04.2011*

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“DN & NAT ENERGJI” SH.P.K NE AKTIVTETIN E PRODHIMIT TE  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____